



Funded by
the European Union



BE për përfshirjen në Tregun e Punës (EU4LMI)

Pyetje dhe Përgjigje në kuadër të Thirrjes për Projekt Propozime publikuar më 9 Gusht 2024

	Pyetje	Përgjigje
1	A mund të aplikohet në më shumë se 1 LOT?	Çdo subjekt që plotëson kriteret e pranueshmërisë për të aplikuar në këtë thirrje, mund të aplikojë vetëm në një LOT, si në rastin e aplikimit të vetëm, ashtu dhe si lead partner në rastin e aplikimit të përbashkët. I njëjti subjekt ka të drejtën të jetë bashkë-aplikant në maksimumi dhe 2 propozime të tjera në LOTe të ndryshme.
2	A mundet që një subjekt të jetë aplikant kryesor (lead applicant) dhe bashkë-aplikant co-applicant) në të njëjtin LOT (dhe në max e propozimeve 3)	Entitetet që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë për të aplikuar në këtë thirrje, mund të jenë lead aplikant në një propozim dhe maksimumi bashkë-aplikantë në 2 projekt propozime të tjera. Në rast se projektet janë në të njëjtin LOT, aplikanti duhet të sigurojë që aktivitetet, përfituesit, mbulimi territorial, kostot të mos mbivendosen dhe të jetë i qartë roli në të gjitha propozimet. Çdo propozim do të shqyrtohet me kujdes për të mos patur mbivendosje në të gjitha aspektet e thirrjes.
3	Nëse një NGO është aplikant kryesor në LOT 1 me një bashki, a mund të jetë dhe aplikant kryesor në LOT 2? Sa herë mund të marrë pjesë një NGO si bashkë-aplikant? Po bashkitë mund të bëhen më shumë se dy herë bashkë-aplikant në	Një aplikant mund të jetë aplikant kryesor vetëm një një LOT. Entitetet që janë në përputhje me kriteret e pranueshmërisë në këtë thirrje, mund të aplikojnë në cilindo nga tre LOT-et, por nuk mund të paraqesin më shumë se një (1) propozim si aplikant kryesor. Aplikimet si bashkë-aplikant nuk mund të jenë më shumë se dy (2), për të gjithë aplikantët që janë në përputhje me kriteret e pranueshmërisë së thirrjes.

	të njëjtin LOT? Po në LOT-e të ndryshme?	
4	Përveç OJF/ ndërmarrje sociale, dhe bashki, a mund të aplikojnë dhe entitete të tjera publike si institucione, universitete, apo dhe biznese?	Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve në këtë thirrje përfshijnë OJF, ndërmarrje sociale dhe bashki, si aplikantë. Çdo entitet tjetër publik apo privat mund të jetë pjesë e partneriteteve lokale dhe forcimit të qasjes gjithëpërfshirëse dhe të integruar, por jo në rolin e aplikantit apo të bashkë-aplikantit.
5	A mundet që disa bashki të aplikojnë së bashku, pa partner organizatë, por ta nënkontraktjnë atë?	Bashkitë janë të ligjshme të aplikojnë vetëm, si aplikant kryesor apo bashkë-aplikant. Çdo formacion është i mundur mes aplikantëve në përputhje me kriteret e thirrjes, në funksion të qëllimit të projekt propozimeve. Konsideroni që thirrja thekson që në rastin e aplikimeve të përbashkëta (konsortium), aplikanti kryesor është drejtpërdrejtë përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit së bashku me bashkë-aplikuesit. Nën-kontraktimi lejohet për shërbime specifike, por jo për zbatimin e projektit. Nën-grantimi nuk lejohet.
6	A mundet që një organizatë të jetë partnere për dy bashki të ndryshme?	Po, një organizatë në përputhje me kriteret e pranueshmërisë, mund të jetë partnere për dy bashki të ndryshme në rolin e bashkë-aplikantit. Çdo subjekt që plotëson kriteret e pranueshmërisë mund të jetë aplikant kryesor vetëm në një propozim dhe bashkë-aplikant deri në maximumi dy (2) propozime të tjera.
7	Çfarë dokumenta mbështetese duhet të paraqiten? Në rastin e aplikimeve nga më shumë se një partner, duhet të sjellin dokumentacion mbështetës dhe për bashkë-aplikantët?	Referohuni kriterëve për dokumentacionin mbështetës në dokumentin e thirrjes (Session 10 “What to submit in the application package”), si për aplikantët në rastin e OJF/ndërmarrjeve sociale dhe në rastin e bashkive, po ashtu dhe në rastin kur janë në rolin e bashkë-aplikantëve.
8	A duhet patjetër që aplikantët OJF të jenë me seli dhe aktivitet në bashkitë e propozuara?	Në kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve (Session 9 “Eligibility of Applicants”, në rastin e organizatave të shoqërisë civile dhe ndërmarrje sociale, kërkohet të kenë eksperiencë të mëparshme në bashkitë e targetuara, si dhe eksperiencë të mëparshme në zbatimin e projekteve të ngjashme, pavarësisht selisë së tyre.
9	Na duhet një marrëveshje bashkëpunimi me ZRP dhe Bashkitë partnere që në prezantimin e	Për aplikimet e përbashkëta, thirrja kërkon si pjesë të paketës së aplikimit dhe marrëveshjen e partneritetit (MoU) ndërmjet aplikantit kryesor dhe bashkë-aplikantëve (mbi rolet,

	projektit apo mund ta bëjmë pas miratimit dhe fillimit të projektit?	përgjegjësitë dhe menaxhimin financiar për projektet e propozuara) (shtojca 5). Marrëveshjet e bashkëpunimit me ZRP apo me bashkitë nuk janë të detyrueshme.
10	Marrëveshja e bashkëpunimit me bashkinë është ekskluzive me një organizatë për një LOT të caktuar?	Marrëveshja e bashkëpunimit (MoU) (shtojca 5) kërkohet në rastin e aplikimeve të përbashkëta dhe është pjesë e paketës së aplikimit. MoU lidhet ndërmjet aplikantit kryesor dhe bashkë-aplikantëve mbi rolet, përgjegjësitë në menaxhimin programatik dhe menaxhimin financiar të projekt propozimit. Marrëveshjet e bashkëpunimit në rast tjetër nuk janë të detyrueshme dhe nuk janë ekskluzive.
11	Udhëzimet janë shumë të qarta dhe të sakta, kemi vetëm një pyetje, përveç faktit që punonjësit e bashkisë nuk do të mund të paguhen me pagë nga projekti, atëherë, cilat janë disa nga linjat e buxhetit që lejohen për bashkitë?	Në dokumentin e thirrjes janë përcaktuar llojet e shpenzimeve të papranueshme. Referojuni sesionit 8 (Session 8 “Budget available”, further sub-sessions 8.1, 8.2, 8.3) në lidhje me buxhetin dhe llojet e aktiviteteve dhe shpenzimeve të papranueshme, si dhe konsideratave të tjera financiare. Gjithashtu referojuni kuadrit ligjor për qeverisjen vendore si dhe VKM të miratuara në lidhje me programet e punësimit të referuara në këtë thirrje.
12	A mund të jetë bashkia Aplikant Kryesor?	Po. Bashkitë e targetuara në thirrje, mund të aplikojnë si aplikant i vetëm, apo në konsortium në rolin e aplikantit kryesor, apo dhe në rolin e bashkë-aplikantit. Thirrja thekson që aplikanti kryesor nuk mund të jetë ndërmjetësues, por drejtpërdrejtë përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit së bashku me bashkë-aplikuesit. Nën-grantimi nuk lejohet.
13	A është kusht që bashkia të aplikojë në partneritet me një OJF apo mund të aplikojë dhe e vetme.	Partneriteti në aplikim nuk është kusht. Bashkitë mund të aplikojnë vetëm, apo në partneritet me entitetet e tjera që janë aplikantë të ligjshëm në këtë thirrje. Thirrja inkurajon aplikimet e përbashkëta (në partneritet), në përputhje me qëllimin e thirrjes. Në rastin e aplikimeve të përbashkëta, aplikimet kanë një aplikant kryesor dhe maksimumi dy (2) bashkë-aplikantë.
14	Deri në sa projekte mund të aplikojë një bashki?	Çdo aplikant që plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe ligjshmërisë në këtë thirrje, mund të aplikojë deri në tre (3) propozime si vijon: vetëm me një (1) propozim në një LOT si aplikant i vetëm dhe si aplikant kryesor në rastin e aplikimit të përbashkët dhe maksimumi deri në dy (2) propozime si bashkë-aplikant.
15	AKPA mund të jetë bashkë aplikuese me organizatën, apo mund të jetë mbështetëse e projektit?	Aplikantë janë vetëm entitetet që plotësojnë kriteret për të aplikuar. Aplikantët mund të jenë dhe bashkë-aplikantë në rastin e aplikimeve të përbashkëta. AKPA do të mbështesë zbatimin e projekteve fituese të skemës së granteve. Thirrja ka për qëllim të zhvillojë dhe forcojë modelet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive, si dhe mekanizmat për menaxhimin e integruar

		të rasteve duke përfshirë bashkitë e targetuara, AKPA-n, ofruesit e shërbimeve të specializuara dhe aktorët e tjerë relevantë në nivel lokal dhe rajonal.
16	Në rastin kur aplikanti është OJF, duhet që në momentin e aplikimit të ketë të lidhur marrëveshje me Bashkinë apo AKPA-n?	Marrëveshjet e bashkëpunimit me ZRP apo me bashkitë nuk janë të detyrueshme. Për aplikimet e përbashkëta, thirrja kërkon si pjesë të paketës së aplikimit dhe marrëveshjen e partneritetit (MoU) ndërmjet aplikantit kryesor dhe bashkë-aplikantëve (mbi rolet, përgjegjësitë dhe menaxhimin financiar për projektet e propozuara) (shtojca 5).
17	Mund të aplikojnë në konsorcium OJF + OJF; OJF + Bashki?	Një entitet që plotëson kriteret e pranueshmërisë për të aplikuar, mund të aplikojë vetëm në një LOT në rast të aplikimit të vetëm dhe si aplikant kryesor në rastin e aplikimit të përbashkët. I njëjti entitet ka të drejtën të jetë bashkë-aplikant në maksimumi dhe 2 propozime të tjera në LOT-e të ndryshme. Konsorcium mund të përbëhet maksimumi nga tre partnerë dhe këto mund të jenë organizata të shoqërisë civile/ndërmarrje sociale dhe/ose bashki.
18	MoU mund të jetë në fillim në shqip dhe më pas e përkthyer në anglisht? Sepse bashkia nuk nënshkruan MoU në gjuhë të huaj.	Po, MOU-në mund ta nënshkruani në gjuhën shqipe dhe më pas ta përktheni në anglisht.
19	Deklarata e qëllimit plotësohet vetëm nga aplikanti kryesor apo edhe nga bashkë aplikanti?	Deklarata e qëllimit plotësohet nga aplikanti në rastin e aplikimit të vetëm dhe në rastin e aplikimit të përbashkët plotësohet vetëm nga aplikanti kryesor. Megjithatë qëllimet e vendosura në këtë dokument duhet të realizohen nga të gjithë partnerët e projektit, sipas roleve dhe përgjegjësisë që ka secili.
20	LOT 1 është i lidhur me këshillimin intensiv për karrierën dhe programet e nxitjes së punësimit. Në referencë është dhënë VKM 401, dt.19.06.2024. Kjo do të thotë që duhet t'i përmbahemi vetëm kësaj VKM në hartimin e propozimit?	Projekt propozimet duhet të jenë në përputhje me standardet dhe kriteret sipas kuadrit ligjor ekzistues në lidhje me programet e nxitjes së punësimit, qëllimit dhe përcaktimeve të LOT dhe thirrjes. Në vijim të kuadrit ligjor për punësimit dhe aftësimin, VKM “Për Përcaktimin e Procedurave, Kriterëve dhe Rregullave për Zbatimin e Programit të Nxitjes së Punësimit mëpërmjet Riintegrit Social”, shërben si referencë në hartimin e projekt propozimeve.
21	LOT 2 është i lidhur me trajnime për aftësimin bazë për të papunë afatgjatë ose që nuk e kanë	AKPA me mbështetjen e UNDP ka zhvilluar një model mësimor të përshtatur dhe fleksibël mbi aftësitë bazë në shkrim lexim, numerike dhe digjitale për punëkërkuarit e rritur që nuk kanë përfunduar arsimin bazë në Shqipëri në kuadrin e projektit SCUL “Mbështetje për mësimin e

	përfunduar arsimin e detyrueshëm, në bazë të kurrikulave nga projekti SCUL? A mund të kemi një informacion mbi projektin SCUL dhe si mund t'i aksesojmë këto kurrikula?	vazhdueshëm për të papunët”. Raporte dhe praktika, si dhe informacion më shumë mund t'i gjeni në faqen e UNDP si dhe te AKPA. Të interesuarit mund ta kërkojnë kurrikulën e SCUL me email në eu4lmi.al@undp.org .
22	LOT 3 është për PAK. A mund të financohet një program që ka target trajnimin dhe certifikimin e job coaches dhe mentors për PAK?	Projekt propozimet duhet t'u përgjigjen objektivave dhe prioriteteve të LOT-eve përkatëse të specifikuar në këtë thirrje si dhe të kontribuojnë në rezultatet dhe në impaktin e synuar për përfituesit finalë, duke siguruar që aktivitetet/ndërhyrja e propozuar të mos të jenë të segmentuara/fragmentizuara dhe që nuk janë të lidhura me qëllimin e projekt propozimit
23	Programet e nxitjes së punësimit sipas VKM janë 6 mujore, ndërsa kohëzgjatja minimale e projektit është 8 muaj, pra mund të zhvillohet vetëm një kurs. A mund të zhvillohen më shumë se 1 kurs paralel?	Po, nëse kapacitetet e aplikantit janë të tilla, mund të parashikohen dhe kurse paralele, duke u kujdesur që aktivitetet të jenë të tilla që të arrijnë qëllimin dhe rezultatet e projektit në përputhje me objektivat dhe prioritetet e LOTeve përkatëse të thirrjes.
24	Sa është kohëzgjatja e dhënies së kurrikulave sipas SCUL? A duhen përdorur plotësisht këto kurrikula, apo janë referencë dhe mund të përshtaten ne program dhe në kohë?	Programi i Trajnimit për Aftësitë Bazë është një program trajnimi me kohëzgjatje 3 mujore, për aftësitë bazë të shkrimit, leximit, matematikës dhe digjitale, i dedikuar dhe përshtatur për nevojat e punëkërkesve përfitues. Kurrikulat e zhvilluara mund të përdoren si referencë, por aplikuesi mund të përdorë edhe kurrikula të zhvilluar më parë. Të gjithë aplikantët e interesuar mund të kërkojnë dokumentacionin përkatës të kurrikulave nëpërmjet email në eu4lmi.al@undp.org .
25	A mund të përdorim metoda dhe praktika të tjera, të cilat i kemi përdorur në eksperiencën tonë për të tre LOTet, përveç këtyre të dhëna si referencë?	Një nga objektivat e thirrjes është që të replikojë, shtrijë dhe kapitalizojë modelet dhe praktikatat e mira ekzistuese dhe më tej të nxisë modele dhe praktika të reja, të cilat mund të përdoren në vijim nga AKPA për hartimin e programeve të ndryshme në fushën e punësimit dhe aftësimin për të gjitha grupet e cënueshme.
26	LOT 1 dhe 2 janë për të 4 target grupet – a mundet që të targetojmë vetëm një target grup nga këto të 4, apo duhen t'i targetojmë të gjithë?	LOT 1 dhe 2 mbulon të katër grupet e synuar të thirrjes. Në varësi të projekt idesë suaj mund të përcaktoni dhe target grupin dhe /ose target grupet tuaja.

27	LOT 3 targeton PAK, a mund të targetojmë përvec PAK dhe anëtarë të tjerë të familjes?	LOT 3 targeton vetëm PAK. Përfituesit duhet të jenë punëkërkuar të papunë të regjistruar apo që regjistrohen gjatë zbatimit të projektit, në bashkëpunim me drejtoritë rajonale dhe zyrat e punës. Anëtarë të familjeve dhe komuniteti në përgjithësi, janë përfitues indirektë të projekteve nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, por nuk janë përfitues direkt/të drejtpërdrejtë të projektit.
28	A mund ta shpjegoni të gjithë përfituesit duhet të jenë nga zyrat e punës? Nëse kemi përfitues nga grupe vulnerabël që nuk janë të regjistruar në zyrën e punës, këta nuk mund t'i konsiderojmë përfitues?	Përfituesit e projekteve duhet të jenë nga këto grupe të synuar, si punëkërkuar të papunë të regjistruar në zyrat e punës ose që regjistrohen në zyrat e punës gjatë zbatimit të projektit. Për këtë keni dhe shtojcën 4 "Deklarata e Qëllimit".
29	Si do të procedohet me zyrat e punës dhe drejtoritë rajonale të punësimit për përfituesit?	Që në ideim kërkohet që projekt propozimet të nxisin partneritetin dhe të forcojnë bashkëveprimin dhe ndërveprimin mes aktorëve në nivel lokal. Kjo thirrje është në bashkëpunim me AKPA dhe drejtoritë rajonale dhe zyrat e punës janë referentë për përfituesit që targetojnë projekt propozimet. Nëpërmjet shtojcës 4 deklaratës së qëllimit, kërkohet që të përcaktoni target grupet që do të mbuloni dhe në numër duke u konsultuar me drejtoritë rajonale të punësimit përkatëse sipas bashkive që targetoni në aplikim.
30	A mund të aplikojë person i punësuar, por është i vetmi person që punon në një familje me 5 anëtarë, banues në zonë rurale?	Të gjithë përfituesit e projekteve duhet të jenë të regjistruar si punëkërkuar të papunë në zyrën përkatëse të punës në bashkinë e synuara; ose duhet të referohen në zyrën përkatëse të punës për t'u regjistruar në momentin e zbatimit të projektit. Vetëm përfaqësuesit e grupit të synuar, të cilët janë punëkërkuar të papunë dhe të regjistruar, mund të kenë të drejtë për mbështetje në cilindo nga tre LOT-et.
31	Në grupin 15-29 vjeç, 15-16 vjeç nuk mund të regjistrohen si punëkërkuar	Te gjithë personat 15-29 vjeç NEET mund të regjistrohen si punëkërkuar në zyrën përkatëse të punësimit. Një person në moshë 15-16 vjeç punësohet, ISHPSHSH-ja lëshon autorizim vetëm për: a) Fëmijët nga mosha 15 deri në 16 vjeç, që punësohen gjatë pushimeve shkollore vetëm në punë të lehta. b) Fëmijët nën moshën 15 vjeç ose fëmijët, që janë duke ndjekur arsimin e detyrueshëm me kohë të plotë, të cilët mund të punësohen për qëllime të veprimtarive kulturore ose të ngjashme me to, që nuk çenojnë sigurinë, shëndetin ose zhvillimin e fëmijëve si dhe

		pjesëmarrjen e tyre në shkollë, në programet profesionale, udhëzuese ose trajnuese, të miratuara nga institucionet përgjegjëse, ose zotësinë e fëmijëve për të përfituar nga ky formim.
32	Propozimi mund të përfshijë më shumë se një bashki? Këto bashki duhet të jenë të të njëjtit qark, apo mund të jenë bashki dhe nga qarqe të ndryshme?	Projekt propozimet mund të përfshijnë një ose më shumë se një bashki nga 19 bashkitë e targetuara nëpërmjet thirrjes. Bashkitë mund të jenë të të njëjtit qark ose dhe të qarqeve të ndryshme. Bashkëpunimi juaj në këtë rast do të jetë me drejtoritë rajonale të punësimit të bashkive përkatëse.
33	A mundet që një projekt propozim të përfshijë dhe bashki jashtë këtyre 19 bashkive, nëse aktivitetet janë të tilla që mbulon dhe territorin e një bashkie kufitare?	Projekt propozimet duhet të shtrihen vetëm në 19 bashkitë e targetuara në thirrje. Çdo aktivitet jashtë mbulimit gjeografik të thirrjes nuk është i pranueshëm.
34	A mund të përfshihen në projekt dhe individë të grupeve të targetuara, por që vijnë nga zona të tjera jashtë bashkive të targetuara (psh, në qendrat komunitare në x vend vijnë dhe përfitues nga zona/fshatra të bashkive të tjera)	Individë të grupeve të targetuara duhet të jenë ose punëkërkuar të papunë të regjistruar në zyrat e punës të bashkive përkatëse që mbuloni, ose që regjistrohen gjatë zhvillimit të projektit. Çdo individ tjetër nuk është përfitues direkt/drejtëpërdrejtë i projektit.
35	Ne LOT II, projekti duhet të zhvillohet në të 19 bashkitë, apo si në të dhënat e përgjithshme në një ose disa prej tyre.	Projekt propozimet mund të përfshijnë një ose më shumë se një bashki nga 19 bashkitë e targetuara nëpërmjet thirrjes për të tre LOT-et.
36	Organizatat mund të aplikojnë vetëm në një bashki të qarkut x apo në të gjitha bashkitë e qarkut?	Në rastin e aplikimeve të përbashkëta, aplikanti kryesor mund të hyjë në partneritet deri në dy bashkë-aplikantë. Në këtë rast, organizata mund të aplikojë me një apo me dy bashkitë e qarkut. Megjithatë aktivitetet e projektit mund të shtrihen në më shumë bashki.
37	Aplikimet duhet të dorëzohen vetëm me email apo dhe me postë apo dorazi?	Aplikimet duhet të dorëzohen vetëm në email në adresën eu4lmi.al@undp.org me subjektin EU4LMI Thirrje për propozime – LOT (specifiko LOT) – emri i aplikantit.

38	Aplikimi duhet të jetë në anglisht? Po dokumentacioni mbështetës duhet përkthyer? Si psh bilanci, apo cv e burimeve njerëzore	Formatet e paketës së aplikimit duhet të jenë të plotësuara në anglisht. Dokumentacioni mbështetës nuk ka nevojë të përkthehet. CV e burimeve njerëzore që propozohen për zbatimin e projekteve duhet të jenë në anglisht si pjesë e paketës së aplikimit.
39	Në rast se nuk i kemi ende të përcaktuar të gjitha cv mund të përmendim vetëm pozicionet?	Grupi kryesor i zbatimit të projektit duhet të jetë i përcaktuar si burimet njerëzore, këshillues trajnues, pra grupi i cili ka rolin kryesor në zbatimin e projektit. CV duhet të jenë pjesë e dokumentacionit mbështetës në paketën e aplikimit.
40	Bilanci duhet të jetë i vitit të mëparshëm, a mjafton të jetë një parashikim i të ardhurave (turnover) i vitit aktual?	Kërkohet bilanci i vitit të mëparshëm në aplikim. Në rast përzgjedhjeje, UNDP do të vlerësojë kapacitetet menaxhuese dhe të riskut për secilin nga aplikantët e përzgjedhur.
41	Në rast se subjekti i email nuk është i plotë, a skualifikohet projekti?	Subjekti i email duhet të jetë i plotë, por nuk është kriter skualifikues. Ndiqni me kujdes listën e kontrollit administrativ dhe të pranueshmërisë për të siguruar që propozimi është në përputhje me kriteret e verifikimit për të vazhduar me fazën e vlerësimit.
42	Në rast se një email nuk i mban dot të gjithë attachments, a mund të dërgohet në disa emaile?	Po mund të dërgohet në disa emaile, në rast të tillë, duke specifikuar në email përmbajtjen e materialeve dërguese dhe që do të dërgoni në emailin tjetër. I gjithë dokumentacioni duhet të dërgohet brenda afatit. Në këto raste, emërtoni secilin email sipas rradhës: Email 1, Email 2 etj.
43	A duhet firmosur deklarata e qëllimit si në rastin e aplikimit të vetëm dhe në aplikimin me partner? A duhet firmosur nga Drejtoria Rajonale e Punësimit?	Deklarata e qëllimit duhet firmosur në të dy rastet, dhe tregon që konsultimi me drejtorinë përkatëse rajonale të punësimit është kryer. Nuk është e nevojshme firmosja nga Drejtoria Rajonale e Punësimit.
44	Sa projekte pritet që të financohen nga skema e granteve?	Fondi në dispozicion për secilin LOT si dhe masa e financimit për grant janë përcaktuar në thirrje. Numri i projekteve që pritet të financohen nga skema e granteve është në varësi të projekt propozimeve të dërguara dhe të vlerësuara pozitivisht. UNDP rezervon të drejtën të mos përdorë gjithë fondin në dispozicion. Gjithashtu UNDP rezervon të drejtën për të transferuar fondin nga një LOT në tjetrin bazuar në cilësinë e projekt propozimeve të marra.

45	Kostot e projektit janë 100%, në rast se përfshijmë në aplikim dhe bashkëfinancim a rrit vlerën e projektit?	Mbështetja financiare nga grantet do të jetë 100%. Nuk kërkohet bashkëfinancim
46	Cfarë nënkupton që nën-grantimi nuk lejohet? A lejohet nënkontraktimi?	Aplikantët janë përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projekteve të tyre, ato nuk mund të veprojnë si ndërmjetësues. Në këtë kuadër nën-grantimi nuk lejohet. Nënkontraktimi i shërbimeve apo blerjeve të nevojshme sipas aktiviteteve të projektit është i lejuar. Në formatin e buxhetit të gjitha përlllogaritjet financiare duhet të shpjegohen qartë në notën shpjeguese në kolonën respektive.
47	Si do të parashikohen marrëdhëniet financiare mes partnerëve?	Në rastin e aplikimeve të përbashkëta, aplikanti kryesor dhe bashkë-aplikanti/ët duhet të hartojnë memorandumun e partneritetit (MoU) nënshkruar mes palëve. MoU ka për qëllim mirëmenaxhimin programatik dhe financiar mes partnerëve gjatë zbatimit të projektit. Në rastin e përzgjedhjes së projekteve fituese që janë në partneritet, aplikanti kryesor do të bëhet përfitues i grantit identifikuar si grantmarrës. Në këtë rast, ai mban përgjegjësi për menaxhimin programatik dhe financiar të projektit dhe raporton për të gjithë partnerët. Në këtë kuadër, vendosja e qartë e rregullave të partneritetit bazuar në procedura dhe manuale është aspekt shumë i rëndësishëm në zbatimin e projektit dhe respektimin e marrëveshjes së grantit.
48	A lejohen shpenzimet për blerje të pajisjeve dhe rinovim në LOT-in 1 dhe 2? Në LOT-in 3 është e cituar	Blerjet të pajisjeve të nevojshme për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve janë të lejuar vetëm në LOT 3, duke siguruar që këto investime kontribuojnë drejtpërsëdrejti në objektivat e LOT 3. Në LOT 1 dhe 2 nuk janë të lejuara. Në rastin e target grupeve PAK të përfshirë në projekte të LOT 1 dhe 2, shpenzime të lidhura me akomodimin e arsyeshëm janë të pranueshme dhe duhet të jenë të detajuara në buxhet.
49	Sa mund të shpenzohet për akomodimin e arsyeshëm?	Akomodimi i arsyeshëm është për PAK. Jo më shumë se 20% e grantit për LOT 3. Në rastin e LOT 1 dhe 2 në varësi të numrit të PAK të targetuar dhe nevojave të tyre, kostot e akomodimit të arsyeshëm duhet të jenë të argumentuara dhe të detajuara në buxhet.

50	Prokurimi i pajisjeve dhe shpenzime për akomodimin e arsyeshëm është vetëm për PAK dhe LOT 3, në rast se për LOT 1 dhe 2, aplikimi përfshin dhe PAK a duhet të llogarisim prokurim të pajisjeve dhe shpenzime për akomodimin e arsyeshëm për këtë target grup?	<p>Blerjet të pajisjeve të nevojshme për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve janë të lejuar vetëm në LOT 3, duke siguruar që këto investime kontribuojnë drejtpërdrejt në objektivat e LOT 3. Në LOT 1 dhe 2 nuk janë të lejuara. Në rastin e target grupeve PAK të përfshirë në projekte të LOT 1 dhe 2, shpenzime të lidhura me akomodimin e arsyeshëm janë të pranueshme dhe duhet të jenë të detajuara në buxhet.</p> <p>Akomodimi i arsyeshëm është për PAK. Jo më shumë se 20% e grantit për LOT 3. Në rastin e LOT 1 dhe 2 në varësi të numrit të PAK të targetuar dhe nevojave të tyre, kostot e akomodimit të arsyeshëm duhet të jenë të argumentuara dhe të detajuar në buxhet.</p>
51	Në LOT 1, në planin Individual të Punësimit ose Vetëpunësimit, a mundet të parashikohet pagesë për aftësim profesional apo blerje materiale ose pajisje për realizimin e planit individual për personat përfitues që të punësohen ose vetëpunësohen dhe nëse po, cila është vlera maksimale për person.	<p>Per LOT 1, shpenzimet e pranueshme për përfitues nuk duhet të tejkalojnë ato të parashikuara në VKM e miratuar dhe duhet të jenë në përputhje me kriteret e përcaktuara në LOT.</p> <p>Në rast se personat do të referohen për punësim apo vetëpunësim, mund të përdoren edhe programet e reja të nxitjes së punësimit, në bashkëpunim dhe koordinim me specialistët e zyrave të punës.</p>
52	A duhet hapur llogaria bankare që në aplikim?	Jo, nuk është e nevojshme që në aplikim. Në rast përzgjedhjeje aplikanti duhet të ketë llogari bankare të dedikuara.
53	Marrëveshja e bashkëpunimit me bashkinë është eskuzive me një organizatë për një LOT të caktuar?	Jo detyruesisht. Marrëveshja e bashkëpunimit (MoU) lidhet në rastin e aplikimeve të përbashkëta midis aplikantit kryesor dhe bashkë-aplikantit/ve me qëllim mirëmenaxhimin programatik dhe financiar të projektit, duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë mes partnerëve.
54	A mund të bëhet aplikimi nga individë, pa qenë pjesë e një OJF?	Jo. Thirrja targeton organizatat e shoqërisë civile, ndërmarrjet sociale dhe bashkitë (19 bashkitë e targetuara në thirrje), në përputhje me kriteret përkatëse të pranueshmërisë të listuara në dokumentin e thirrjes.
55	Cilat subjekte janë të lejueshme për aplikime në këtë thirrje? SME, Trupa Trajnues etj. janë të lejueshme?	Thirrja targeton organizatat e shoqërisë civile, ndërmarrjet sociale dhe bashkitë (19 bashkitë e targetuara në thirrje), në përputhje me kriteret përkatëse të pranueshmërisë të listuara në dokumentin e thirrjes. Projektet mund të angazhojnë aktorë dhe specialistë në përputhje me qëllimet dhe prioritetet e thirrjes dhe LOT-eve, dhe specifikave të projekteve të tyre.

56	Pershendetje, sa është fondi në dispozicion të projektit?	Fondi total i skemës së granteve është 1,2 milion euro, i ndarë sipas LOT-eve. Buxheti total per projektet individuale është 60,000 Euro deri në 200,000 euro.
57	Sa është përqindja e kostove të burimeve njerëzore/kosto administrative?	20%. Ndiqni instruksionet në formularin e buxhetit (shtojca 3).
58	Për personat që janë të papunë, sa kohë duhet të kenë që janë të papunë?	<p>Për LOT 1. Përfituesit e këtij programi janë punëkërkuarit e papunë të regjistruar në Zyrën e Punës, të cilët evidentohen nga ndërveprimi me sistemin tatimor se kanë më shumë se 6 muaj të papunë. Ky proces do të verifikohet nga AKPA.</p> <p>Per LOT 2. Punëkërkuarit e papunë me të drejtë pjesëmarrjeje janë trajtuar paraprakisht me shërbimet e punësimit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi nga specialisti përkatës i punësimit pranë Zyrës së Punës. Nuk është përcaktuar një kohë që duhet të jenë të papunë të regjistruar. Përfituesit janë pa arsim ose me arsim bazë të papërfunduar.</p> <p>Për LOT 3. Punëkërkuarit e papunë me të drejtë pjesëmarrjeje janë trajtuar paraprakisht me shërbimet e punësimit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi nga specialisti përkatës i punësimit pranë Zyrës së Punës. Nuk është përcaktuar një kohë që duhet të jenë të papunë të regjistruar.</p>
59	A lejohet që ekspertë apo trajnerë në projekt të përfshihen persona që janë punonjës të zyrës së punës apo bashkive?	Ndërsa propozimet tuaja mund të përfshijnë dhe angazhojnë ekspertë dhe trajnerë në funksion të qëllimit dhe aktiviteteve të parashikuara të propozimit si dhe në përputhje me kërkesat dhe kriteret e LOT-eve përkatëse të thirrjes dhe qëllimit të përgjithshëm të thirrjes, punonjës të bashkive mund të angazhohen për të kryer detyrat e tyre funksionale, sikurse dhe zyrat e punës janë të angazhuara në mbështetje të zhvillimit të projekteve, por nuk mund të paguhen nga projekti.
60	A mund të përfshihen si zë buxhetor pagesa ndaj trajnerëve dhe ekspertëve për dhënien e trajnimeve apo këto trajnime do mbulohen nga AKPA dhe UNDP?	<p>Në përputhje me objektivat e LOT-eve përkatëse, në funksion të metodologjisë së propozuar, hartimi i buxheteve të propozimeve i përgjigjet aktiviteteve dhe planit të punës. Nëse trajnime dhe trajnerë janë marrë në konsideratë në kuadër të zhvillimit të projekt propozimeve tuaja, atëherë kostot përkatëse duhet të konsiderohen në hartimin e buxheteve respektiv.</p> <p>Për projektet fituese UNDP do të ofrojë trajnime specifike për grantmarrësit mbi modelet përkatëse sipas LOT-ve dhe mbi kapacitetet teknike në menaxhimin e projekteve, dhe për LOT 3 trajnim specifik për punësimin me mbështetje dhe rehabilitimin në punë për PAK, në</p>

		mënyrë që të rrisë kapacitetet teknike dhe administrative të grantmarrësve në zbatueshmërinë e projekteve.
61	A duhet patjetër MoU me Bashkinë?	MoU është marrëveshje partneriteti (Shtojca 5) në rastin e aplikimeve të përbashkëta, midis aplikantit kryesor dhe bashkë-aplikantit/ëve, mbi rolet, përgjegjësitë në menaxhimin programatik dhe financiar të projekteve. Marrëveshjet e partneritetit me bashkitë, në rast se nuk janë partnerë në projekt, nuk janë të detyrueshme. Megjithatë, në çdo rast projekt propozimet duhet të nxisin partneritetin dhe të forcojnë bashkëveprimin dhe ndërveprimin mes aktorëve në nivel lokal dhe rajonal.
62	A është kusht partneriteti në këtë thirrje?	Aplikantët që janë në përputhje me kriteret e pranueshmërisë për të aplikuar në këtë thirrje, kanë të drejtën e aplikimeve të vetme (1 aplikant) ose në partneritet (aplikime të përbashkëta). Në rastin e aplikimeve të përbashkëta, aplikanti kryesor mund të ketë deri në maksimumi 2 bashkë-aplikantë. Aplikimet e përbashkëta në funksion të partneritetit, duhet të kenë dhe Memorandumin e Bashkëpunimit (MoU) mes aplikantit kryesor dhe bashkëaplikantëve. Memorandume të tjera nuk janë të detyrueshme. Megjithatë, në çdo rast projekt propozimet duhet të nxisin partneritetin dhe të forcojnë bashkëveprimin dhe ndërveprimin mes aktorëve në nivel lokal dhe rajonal.
63	Projekti mund të përfshijë më shumë se 1 Bashki?	Po, projektet mund të përfshijnë një ose më shumë se një nga 19 bashkitë e targetuara në thirrje për projekt propozime.
64	Personat që janë përfshirë në programet e punëve publike në komunitet, a janë të lejueshëm që të vazhdojnë të përfitojnë nga ky projekt?	Referohuni kriterëve për target grupet, “Sesion 3 – Target Final Beneficiaries” në dokumentin e thirrjes. Përfituesit aktual të programeve të punëve publike në komunitet nuk mund të jenë përfitues të këtyre projekteve.
65	A mund të aplikosh së bashku në partneritet me një organizatë?	Aplikantët (organizata të shoqërisë civile/Ndërmjarrje sociale dhe Bashkitë e targetuara) të cilët plotësojnë kriteret e pranueshmërisë së thirrjes kanë të drejtë të aplikojnë për këtë thirrje. Aplikantët mund të aplikojnë të vetëm, apo në partneritet me maksimumi dy aplikantë të tjerë.
66	Në këtë projekt lider duhet të jetë bashkia apo edhe OJF-të?	Të gjithë aplikantët (organizata të shoqërisë civile/Ndërmjarrje sociale dhe Bashkitë e targetuara) të cilët plotësojnë kriteret e pranueshmërisë së thirrjes, në rastin e aplikimeve të

		përbashkëta, mund të jenë aplikant kryesor (vetëm në një propozim) dhe bashkë-aplikantë (deri në maksimumi 2 propozime).
67	A duhet një marrëveshje paraprake me bashkitë nga OJF-të	Vetëm në rastin e aplikimeve të përbashkëta kërkohet memorandumi i bashkëpunimit mes partnerëve në projekt. Në rast se një bashki apo OJF që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë për të aplikuar në këtë thirrje, hyjnë në aplikime të përbashkëta si aplikant kryesor ose bashkë-aplikant, duhet të dorëzojnë dhe Memorandumin e Bashkëpunimit që përcakton rolet dhe përgjegjësitë e partnerëve, të nënshkruar në paketën e aplikimit (shtojca 5). Marrëveshje të tjera nuk janë të detyrueshme.
68	Në LOT-in 3, Punësimi dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuar – personat me aftësi të kufizuar kanë nevojë për një mbështetës në punë. A mund të përfshihen dhe mbështetësit në projekt?	Po, siç edhe është specifikuar në qëllimin dhe prioritetet e LOT 3 si dhe në listën e aktiviteteve të sugjeruara, projekt propozimet në këtë LOT mund të përfshijnë edhe mentorë apo “job coaches”, të cilët do të mbështesin PAK për t’u integruar në vendin (ambientet) e punës.
69	Për të përgatitur më mirë projektet dhe ndërhyrjet, për cilat arsye janë zgjedhur këto bashki? Kanë karakteristika që mund të jenë të rëndësishme për ne?	Skema e granteve e shpallur në këtë thirrje për projekt propozime është pjesë e projektit EU4LMI “BE për Përfshirjen në Tregun e Punës”, me mbështetjen financiare të BE, zbatuar nga UNDP në Shqipëri në partneritet me Shërbimin Publik Suedez të Punësimit (Arbetsförmedlingen) dhe Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPK). Mbulimi territorial i thirrjes është i njëjtë me mbulimin territorial të projektit EU4LMI, të përcaktuar nga BE. Ref. Session 1 “Background of the EU for Labour Market Inclusion Project (EU4LMI)”. Më tepër rreth projektit gjeni në faqen e UNDP Albania.
70	Në rast se OJF ka qendrën jashtë 19 bashkive, por ligjërish vepron në gjithë Shqipërinë, ka të drejtë të aplikojë?	Aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e pranueshmërisë së thirrjes, kanë të drejtën e aplikimit në këtë thirrje. Në rastin e OJF-ve kriteret e pranueshmërisë përcaktojnë ndër të tjera eksperiencën e mëparshme në bashkitë e targetuara dhe në zbatimin e projekteve të ngjashme. Referohuni Session 9 “Eligibility of Applicants”
71	A e ka të drejtën AKPA për të qenë co-applicant?	Aplikantë janë vetëm entitetet që plotësojnë kriteret për të aplikuar. Aplikantët mund të jenë dhe bashkë-aplikantë në rastin e aplikimeve të përbashkëta. AKPA do të mbështesë zbatimin e projekteve fituese të skemës së granteve. Thirrja ka për qëllim të zhvillojë dhe forcojë modelet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive si dhe

		mekanizmat për menaxhimin e integruar të rasteve duke përfshirë bashkitë e targetuara, AKPA-n, ofruesit e shërbimeve të specializuara dhe aktorët e tjerë relevantë në nivel lokal dhe rajonal.
72	Në 2 LOT-et e para synimi është 600 persona, në LOT-in e 3-të është 200 persona. Në momentin që aplikon në një LOT, sa është nr minimal që mund të synosh.	<p>Nëpërmjet projekteve të zhvilluara në LOT 1, EU4LMI synon që 600 punëkërkuar të papunë përfitojnë nga zbatimi i programeve të Këshillimit Intensiv për Punësim</p> <p>Nëpërmjet projekteve të zhvilluara në LOT 2, EU4LMI synon që 600 punëkërkuar të papunë përfitojnë nga trajnimet cilësore, fleksibël, të personalizuar për aftësitë bazë (shkrim-lexim, numerike dhe digjitale).</p> <p>Nëpërmjet projekteve të zhvilluara në LOT 3, EU4LMI synon që 200 punëkërkuar me aftësi të kufizuara punësohen ose marrin aftësim për punë përmes programeve të punësimit me mbështetje dhe zhvillimit të aftësive, duke përfshirë trajnerë, këshillues dhe mentorë.</p> <p>UNDP do të sigurojë që të gjitha projektet bashkarisht të arrijnë indikatorët dhe qëllimet për secilin LOT të Thirrjes.</p>
73	Ne rastin e LOT III a parashikon projekti page per personat me aftesi te kufizuar qe punesohen prsh 12 muaj prane nje institucioni apo biznesi privat?	<p>Projekt propozimet në këtë LOT duhet të jenë në përputhje me qëllimin dhe prioritetet e LOT. Në referencë dhe të listës së aktiviteteve të sugjeruara, propozimet mund të përfshijnë ofrimin e programeve të punësimit me mbështetje, aftësimin dhe rehabilitimit për punë, programe novatore punësimi, trajnimi dhe vetëpunësimi për PAK.</p> <p>Aplikantët janë të inkurajuar të propozojnë ndërhyrje që cilat ofrojnë shërbime të specializuara të punësimit dhe të zhvillimit të aftësive, në qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse, duke siguruar që aktivitetet/ndërhyrja e propozuar të mos të jenë të segmentuara/fragmentizuara.</p>
74	Është e nevojshme të përfshihen bashki/disa bashki si partnerë zyrtarë, apo mund të aplikojmë dhe vetëm pa patur partnerë në projekt?	<p>Për të tre lotet, Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC), Njësitë e Qeverisjes Vendore (bashkitë e synuara), ndërmarrjet sociale kanë të drejtë të aplikojnë në këtë thirrje në përputhje me kriteret e pranueshmërisë.</p> <p>Aplikantët e kualifikuar mund të aplikojnë si aplikues të vetëm ose në aplikim të përbashkët në një ose më shumë se një nga 19 bashkitë e synuara. Aplikimi i përbashkët mund të ketë vetëm 1 aplikant kryesor dhe maksimumi 2 bashkë-aplikues.</p> <p>Në rast aplikimesh të përbashkëta, kërkohet një Memorandum i Partneritetit (MoU) ndërmjet aplikantit kryesor dhe bashkë-aplikantëve (shtojca 5) për rolet, përgjegjësitë në menaxhimin programatik dhe financiar të projekt propozimit.</p>

		<p>Partneriteti juaj me aplikantët e tjerë të kualifikuar kërkohet vetëm në rast të aplikimit të përbashkët. Marrëveshjet e tjera të partneritetit nuk janë të detyrueshme.</p> <p>Megjithatë, në çdo rast, iniciativat e propozuara do të duhet të demonstrojnë partneritet dhe qasje të integruara në zbatim dhe të kontribuojnë në forcimin e ndërveprimit ndërmjet aktorëve të nivelit lokal dhe rajonal.</p>
75	A mundet vetëm dy organizata të jenë co-aplikant dhe bashkia të jetë përfituese, jo si co-aplicant?	Në rastin e aplikimeve të përbashkëta të aplikantëve që janë në përputhje me kriteret e pranueshmërisë për të marrë pjesë në këtë thirrje, aplikimi duhet të ketë një aplikant kryesor dhe maksimumi deri në dy (2) bashkë-aplikantë. Dy organizata mund të jenë partnere në një aplikim të përbashkët, ku një prej tyre duhet të jetë aplikant kryesor dhe tjetra bashkë-aplikant. Projekt propozimi mund të mbulojë një ose më shumë se një nga 19 bashkitë e synuara. Bashkia e targetuar në projekt propozim, mund të jetë partner ose jo në projekt propozimin tuaj.
76	Nëse një organizatë është e lejuar të ketë aplikim vetëm me 2 co-aplikantë, atëherë kjo nënkupton që bashkëpunimi është i kufizuar vetëm në 2 bashki. Po, nëse do duam të aplikojmë në më shumë se 2 bashki (për të njëjtin LOT dhe aplikim)?	<p>Në rastin e aplikimeve të përbashkëta të aplikantëve që janë në përputhje me kriteret e pranueshmërisë për të marrë pjesë në këtë thirrje, aplikimi duhet të jetë një aplikant kryesor dhe maksimumi deri në dy (2) bashkë-aplikantë. Aplikimi mund të mbulojë ndërkohë 1 ose më shumë se një bashki nga 19 bashkitë e synuara.</p> <p>Çdo aplikant që plotëson kriteret e pranueshmërisë, për aplikimet e përbashkëta, ka të drejtën të jetë aplikant kryesor në një (1) propozim (1 Lot), si dhe të jetë bashkë-aplikant në maksimumi dy (2) propozime të tjera, pavarësisht LOT-it. Në rast se projektet janë në të njëjtin LOT, aplikanti duhet të sigurojë që aktivitetet, përfituesit, mbulimi territorial, kostot të mos mbivendosen dhe të jetë i qartë roli në të gjitha propozimet. Çdo propozim do të shqyrtohet me kujdes për të mos patur mbivendosje në të gjitha aspektet e thirrjes.</p>
77	Dy here si co applicant mundet në të njëjtin LOT apo në LOTe të ndryshme?	Çdo aplikant që plotëson kriteret e pranueshmërisë, për aplikimet e përbashkëta, ka të drejtën të jetë aplikant kryesor në një (1) propozim (1 Lot), si dhe të jetë bashkë-aplikant në maksimumi dy (2) propozime të tjera, pavarësisht LOT-it. Në rast se projektet janë në të njëjtin LOT, aplikanti duhet të sigurojë që aktivitetet, përfituesit, mbulimi territorial, kostot të mos mbivendosen dhe të jetë i qartë roli në të gjitha propozimet. Çdo propozim do të shqyrtohet me kujdes për të mos patur mbivendosje në të gjitha aspektet e thirrjes.
78	OJF që nuk kanë një eksperiencë të mëparshme me të tilla projekte, por	Aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e pranueshmërisë së thirrjes, kanë të drejtën e aplikimit në këtë thirrje. Në rastin e OJF-ve kriteret e pranueshmërisë përcaktojnë ndër të tjera

	mund të kenë një projekt propozim të rregullt, a kualifikohen?	eksperiencën e mëparshme në bashkitë e targetuara dhe në zbatimin e projekteve të ngjashme. Referohuni Session 9 “Eligibility of Applicants”
79	Në rast të llogarisë bankare, vetëm lead applicant apo dhe partnerët duhet të kenë llogari bankare të dedikuar?	Aplikanti Kryesor në rast të vlerësimit pozitiv/përzgjedhjes së projektit, duhet të ketë llogari bankare të dedikuar për projektin. Menaxhimi financiar mes partnerëve është subjekt i MoU midis tyre. Aplikanti kryesor si grantmarrës mban përgjegjësi për mbarëvajtjen e gjithë projektit, menaxhimin programatik dhe financiar të tij, detajuar në marrëveshjen e bashkëpunimit (MoU).
80	Llogaria bankare do hapet direkt në bankën e nivelit të dytë apo fondet do kalojnë nëpërmjet Bankës së Shqipërisë?	Aplikanti kryesor në rast të vlerësimit pozitiv/përzgjedhjes së projektit, duhet të ketë llogari bankare të dedikuar për projektin. Në rastin e OJF-ve si aplikant kryesor kërkohet llogari bankare në një bankë të nivelit të dytë. Ne rastin e bashkisë si aplikant kryesor, do të veprohet sipas rregulloreve që janë në fuqi dhe sipas ndryshimeve të fundit. Sipas udhëzimit hapet një llogari e plotë në thesar, e cila është një llogari më vete që menaxhohet nga njësia zbatuese e projektit.
81	Lidhur me kriteret e përzgjedhjes së përfituesve, munden organizatat, bashkitë të vendosin kriteret nga ana e tyre përveç kriterëve të përcaktuar në thirrje?	Të gjithë përfituesit duhet të jenë pjesë e katër grupeve të synuara sipas përcaktimeve të secilit LOT, si dhe të jenë punëkërkues të papunë të regjistruar në zyrën e punës në bashkinë e targetuar, ose që regjistrohen në momentin e përfshirjes në projekt. Në përputhje me qëllimet e thirrjes dhe objektivave të secilit LOT, në linjë me metodologjinë e propozuar dhe qëllimin e projekt propozimit, aplikantët mund të vendosin kriteret përzgjedhjeje të tjera Brenda këtyre target grupeve. Si psh. në grupin e synuar të të rinjve NEET, projektet mund të fokusohen tek të rinjtë që jetojnë në zonat rurale të 19 bashkive, fuqizimin e vajzave, mund të jenë të rinj të papunë afatgjatë, etj.
82	Projekt propozimi duhet të targetojë përfitues nga të 19 bashkitë?	Jo detyrimisht. Projekt propozimet duhet të jenë në përputhje me kriteret e grupeve të synuara dhe të zhvillohen në një ose disa nga 19 bashkitë e targetuara.
83	Në mbulimin territorial të bashkive janë të përfshira dhe njësitë administrative?	Mbulimi territorial i kësaj thirrjeje përfshin 19 bashki. Njësitë administrative të këtyre bashkive janë të përfshira.
84	A mund të propozojmë një projekt bazuar në një projekt tjetër që kemi për punësimin dhe ri-integrimin me	Aplikanti duhet të sigurojë që projektet aktivitetet, përfituesit, mbulimi territorial, kostot të mos mbivendosen me projekte dhe financime të tjera. Çdo propozim do të shqyrtohet me kujdes për të mos patur mbivendosje në të gjitha aspektet e thirrjes.

	një donator tjetër në një zonë tjetër, duke u përqëndruar në modelin pozitiv?	Replikimi dhe promovimi i praktikave të mira dhe modeleve pozitive, si dhe ofrimi i modeleve të reja novatore të aktivizimit në punësim dhe zhvillim të aftësive janë të inkurajuara.
85	Në fund të këtij projekti a është kriter punësimi nga ana e Bashkisë apo Oshc i personave përfitues? Nëse po, cili Lot?	Qëllimi i thirrjes nëpërmjet projekteve të zbatuara në të tre LOT-et është të forcojë modelet gjithëpërfshirëse të aktivizimit në punësim dhe zhvillim të aftësive në 19 bashkitë e synuara, duke përshkallëzuar modelet ekzistuese të programeve aktive të tregut të punës dhe programeve të zhvillimit të aftësive. Impakti i të gjitha projekteve të mbështetura nga kjo skemë e granteve, synon që të gjithë aktorët e tregut të punës të mundësojnë dhe ofrojnë punësim dhe zhvillim aftësish gjithëpërfshirës dhe të integruar për përfituesit e ndihmës ekonomike, NEET, PAK dhe nënat e reja jo të përfshira në punësim - referuar bashkërisht si përfituesit përfundimtarë.
86	A mundet të aplikojë një bashki nga këto 19 të targetuara, e cila ka detyrime financiare, të cilat e pengojnë të përfshihet në programet e nxitjes së punësimit?	<p>Të gjithë aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e pranueshmërisë për të marrë pjesë në këtë thirrje. Sesionin 9 i dokumentit të thirrjes “Eligibility of Applicants” ka të përcaktuar dhe rrethana penalizuese për pjesëmarrjen e aplikantëve:</p> <p>Aplikantët nuk do të jenë në gjendje të marrin pjesë në këtë thirrje dhe as nuk do t'u jepen fonde, në rrethanat e mëposhtme:</p> <p>a) nëse janë në procedurë falimentimi ose falimentimi/likuidimi, nëse kanë hyrë në procedurën e negociimit të marrëveshjes me kreditorët, nëse kanë pezulluar veprimtarinë e tyre;</p> <p>b) nëse janë dënuar për sjellje joprofesionale dhe nëse kanë qenë objekt i një vendimi gjyqësor të formës së prerë (res judicata), d.m.th., nuk mund të ankimohen;</p> <p>c) nëse janë fajtorë për kontakte joprofesionale që mund të provohen;</p> <p>d) nëse nuk kanë shlyer borxhin e tyre lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore ose pagesat e taksave, sipas dispozitave ligjore në Republikën e Shqipërisë;</p> <p>e) nëse u është dhënë një vendim i formës së prerë i barabartë me res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në organizata kriminale ose ndonjë veprimtari tjetër të paligjshme. Aplikantët gjithashtu nuk do të jenë në gjendje të marrin pjesë në këtë thirrje dhe atyre nuk do t'u jepen fonde nëse gjatë thirrjes përcaktohet se:</p> <p>f) aplikanti është në konflikt interesi (për qëllimin e këtij dokumenti, konflikt interesi do të thotë ekzistenca e një interesi privat të aplikantit që ndikon ose mund të ndikojë në funksionin e tij/saj në projekt, si dhe nëse aplikanti ka një funksion publik që ndikon ose mund të ndikojë në funksionin e tij/saj në projekt, aplikimin ose projektin vetë);</p>

		<p>g) aplikanti është fajtor për keqinterpretim ose dhënie të informacionit të rremë që kërkohet si kriter i përshtatshmërisë për thirrjen; ose nuk ka dorëzuar informacionin e kërkuar;</p> <p>h) aplikanti është përpjekur të arrijë informacion konfidencial ose të ndikojë në panelin e vlerësimit gjatë procesit të vlerësimit të projekteve brenda kësaj thirrjeje.</p>
87	Nëse dokumentat kanë peshë më të madhe se mundësia e dërgimit si attachments, si mund të veprojmë?	Mund të përdorni programe të cilat përdoren për të zvogëluar madhësinë e dokumentave. Në rast pamundësie, aplikimi së bashku me dokumentacionin mbështetës mund të dërgohet në disa emaile, në rast të tillë, duke specifikuar në email përmbajtjen e materialeve dërguese dhe që do të dërgoni në emailin tjetër. I gjithë dokumentacioni duhet të dërgohet brenda afatit. Në këto raste, emërtoni emailet sipas rradhës: Email 1, Email 2 etj.
88	Në rast se një degë e një organizate të huaj është e regjistruar në Shqipëri me vendim gjykatë dhe operon në shqipëri, me nipt të rregullt, a mund të aplikojë si bashkë-aplikant?	<p>Aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e pranueshmërisë së thirrjes, kanë të drejtën e aplikimit në këtë thirrje (Referohuni Session 9 “Eligibility of Applicants”). Në rastin e organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC)/ndërmarrjeve sociale, kriteret e pranueshmërisë përcaktojnë ndër të tjera se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Duhet të jetë person juridik aktiv. • Të jetë një organizatë jofitimprurëse, e regjistruar dhe që vepron ligjërisht në Shqipëri (në përputhje me ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001). <p>Në rast se dega e OJF është e regjistruar dhe vepron ligjërisht në Shqipëri nuk përjashtohet nga pjesëmarrja në thirrje.</p> <p>Në referencë të sesionit 10.3. Mandatory supporting documents for the co-applicants” të dokumentit të thirrjes, paketa e aplikimit duhet të ketë për bashkë-aplikuesit: Kopje të regjistrimit në gjykatë nëse bashkë-aplikanti është OJF dhe kopje të NIPT.</p>
89	TVSH është e mbuluar në projekt?	<p>Mbështetja financiare nga grantet do të jetë 100% të kostove të pranueshme. Gjithashtu dokumenti i thirrjes ka të përcaktuar dhe kostot e papranueshme. Në rast se TVSH është e rimbursueshme për aplikantin/aplikantët, cilësojeni në propozimin tuaj, po kështu dhe në rastin nëse TVSH nuk është e rimbursueshme nga aplikanti/aplikantët.</p> <p>Gjatë vlerësimit të kapaciteteve të aplikantëve të suksesshëm, do të vlerësohen të gjitha aspektet e menaxhimit programatik dhe financiar të projekt propozimeve.</p>
90	A mundet të përfshihet një bashki në projekt propozim si partner pa i caktuar buxhet?	Për aplikimet e përbashkëta, thirrja kërkon si pjesë të paketës së aplikimit dhe marrëveshjen e partneritetit (MoU) ndërmjet aplikantit kryesor dhe bashkë-aplikantëve (mbi rolet, përgjegjësitë dhe menaxhimin financiar për projektet e propozuara) (shtojca 5). MoU ka për

		<p>qëllim mirëmenaxhimin programatik dhe financiar mes partnerëve gjatë zbatimit të projektit. Për referencë ndiqni kriteret e vlerësimit mbi partneritetin.</p> <p>Projekt propozimet mund të zbatohen në një ose më shumë se një bashki si aplikim i vetëm, ose si aplikim i përbashkët mes entiteteve në përputhje me kriteret e pranueshmërisë në këtë thirrje.</p> <p>Marrëveshjet e partneritetit me bashkitë, në rast se nuk janë partnerë në projekt, nuk janë të detyrueshme.</p> <p>Megjithatë, në çdo rast projekt propozimet duhet të nxisin partneritetin dhe të forcojnë bashkëveprimin dhe ndërveprimin mes aktorëve në nivel lokal dhe rajonal.</p>
91	Çfarë dokumentacioni mbështetës nevojitet për bashkë-aplikantët (universitet dhe bashki)?	<p>Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve në këtë thirrje përfshijnë OJF, ndërmarrje sociale dhe bashki si aplikantë apo bashkë-aplikantë.</p> <p>Çdo entitet tjetër publik apo privat mund të jetë pjesë e partneriteteve lokale dhe forcimit të qasjes gjithëpërfshirëse dhe të integruar, por jo në rolin e aplikantit apo të bashkë-aplikantit (në këtë rast universiteti).</p> <p>Bashkë-aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e pranueshmërisë sikurse dhe për aplikantin kryesor.</p> <p>Referohuni kriterëve për dokumentacionin mbështetës në dokumentin e thirrjes (Session 10 “What to submit in the application package”) - në rastin kur janë në rolin e bashkë-aplikantëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një kopje të regjistrimit në gjykatë nëse bashkëaplikuesi është një OJF • Një kopje të Numrit të Identifikimit të Tatimpaguesit (NIPT).
92	Për LOT 3, a është e mundur të përfshihen grante për akomodimin në punë për PAK si pjesë e aktiviteteve të projektit, dhe kështu të mos përfshihen këto shpenzime si "kosto të stafit" në buxhet?	<p>Nën-grantimi nuk lejohet.</p> <p>Referojuni sesionit 8 (Session 8 “Budget available”, further sub-sessions 8.1, 8.2, 8.3) në lidhje me buxhetin dhe llojet e aktiviteteve dhe shpenzimeve të papranueshme, si dhe konsideratave të tjera financiare dhe në lidhje me akomodimin e arsyeshëm.</p> <p>Kostot e stafit janë kosto që lidhen me menaxhimin dhe zbatimin e përgjithshëm të projektit.</p>